



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJEOGRAFISË



Programi: **Bachelor**

Drejtimi: **Gjeografi**

Lënda: KULTURË JURIDIKE

<i>Pedagogu:</i>	Fakulteti i Drejtësisë
<i>Ngarkesa:</i>	4 ETCS (2 leksione dhe 1 seminar në javë)
<i>Lloji i lëndës:</i>	me zgjedhje
<i>Programi i studimit:</i>	Bachelor, gjeografi
<i>Viti/semestri:</i>	I/I

Shkurtesë: Kultura juridike është konceptuar si një lëndë e cila është hartuar dhe përmbledhur enkas për dedën Gjeografi, nisur edhe nga specifikat e kësaj degë. Kjo lëndë është e ndërtuar në dy pjesë kryesore: Pjesa e parë është pjesa e përgjithshme e kësaj lëndë, e cila ka në përbërje të saj koncepte juridike bazë në lidhje me kulturën e përgjithshme juridike, në një këndvështrim të përgjithshëm. Ajo studion shtetin, të drejtën, pushtetet brenda shtetit, të drejtat dhe liritë thelelore të njeriut si dhe koncepte të tjera bazë të nevojshme për kulturën e përgjithshme qytetare juridike. Pjesa e dytë është pjesa e posaçme, e cila ka në përbërje të saj koncepte konkrete që lidhen edhe me specifikën e degës së Gjeografisë. Ajo studion konceptet juridike që lidhen me mjedisin, terminologjinë dhe parimet e së drejtës mjedisore, kuptimin e së drejtës mjedisore, vendi i së drejtës mjedisore në kuadrin e përgjithshëm të së drejtës, burimet e së drejtës mjedisore, normat kushtetuese, ligjore e ndërkombëtare në lidhje me të drejtën mjedisore, karakteristikat bazë të së drejtës mjedisore, si dhe sanksionet dhe ndëshkimet në të drejtën mjedisore.

Temat e leksioneve:

1. Hyrje. Objekti, përmbajtja dhe detyrat.
2. Shoqëria, shteti dhe e drejta. Karakteristikat e shtetit.
3. Format e pushtetit shtetëror. (Kuptimi i formës së pushtetit shtetëror)

4. Pushteti legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor.
5. Parimi i ndarjes së pushteteve
6. Organizimi i shtetit dhe struktura e tij sipas Kushtetutës së RSH. (Struktura dhe organet e shtetit. Parlamenti. Kryetari i shtetit. Qeveria).
7. Administrata publike. Forcat e armatosura. Organet e drejtësisë. Organizimi lokal dhe autonomia lokale.
8. Burimet e së drejtës.
9. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut sipas Kushtetutës së RSH.
10. Të drejtat dhe liritë individuale, politike, ekonomike, social kulturore dhe të drejtat dhe liritë në procesin penal.
11. Mjedisi. Terminologjia dhe parimet e së drejtës mjedisore.
12. Kuptimi i së drejtës mjedisore.
13. Burimet e së drejtës mjedisore.
14. Licencimi. Kontrolli dhe informacioni mjedisor.
15. Sanksionet dhe ndëshkimet në të drejtën mjedisore.

Forma e kontrollit dhe vlerësimit

- Detyrim frekuentimi në: 70% të seminareve	
- Angazhimi në seminare:	20% e notës
- Kontrolli përfundimtar: provim me shkrim	80% e notës
- Gjithsej:	100%

Literatura bazë:

1. Omari L., *Parime dhe institucione të së drejtës publike*, EG, Tiranë 2006.
2. Anastasi A., *E drejta kushtetuese*, Adelprint, Tiranë 2011.
3. *Kushtetuta e RSH*.
4. *Konventa Evropiane e të drejtave të njeriut*.
5. *Aktet ligjore dhe ndërkombëtare në lidhje me mjedisin*.

